



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 9 tetor 2019

Z. Agim Veliu, Kryetar
Komuna e Podujevës

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 256/2019

kundër

Komunës së Podujevës

I nderuari z. Veliu,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP)¹, më 2 prill 2019, e ka pranuar ankesën e znj. Blerita Ibërdemaj, në emër të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), parashtuar kundër Komunës së Podujevës, për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesja, më 23 gusht 2018 dhe më 5 shkurt 2019, nëpërmjet postës elektronike, ka paraqitur kërkesë për qasje në faturat e drekave dhe të darkave zyrtare të Komunës së Podujevës, për periudhën dhjetor 2017- gusht 2018. Deri në ditën kur ankuesja ka parashtuar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP, ajo nuk ka marrë përgjigje.

Avokati i Popullit, më 24 prill 2019, i është drejtuar me shkresë kryetarit të komunës së Podujevës, duke kërkuar prej tij informata për veprimet që Komuna i ka ndërmarrë apo që planifikon t'i ndërmarrë, në mënyrë që t'i përgjigjet ankueses në kërkesën për qasje në dokumente publike. Meqenëse Avokati i Popullit nuk ka marrë përgjigje në këtë shkresë, më 27 maj 2019, IAP-ja ka kontaktuar me zyrtarin për informim i Komunës së Podujevës, lidhur me kërkesën e ankueses për qasje në dokumente publike dhe për shkresën e Avokatit të Popullit, me ç' rast është njoftuar nga ai se janë në dijeni për kërkesën e ankueses, por se nuk mund të përgjigjet për të pa marrë të dhënat nga njësia që i ka të dhënat dhe dokumentet e kërkuara. Më 1 gusht 2019, Avokati i Popullit i është drejtuar përsëri me shkresë kryetarit të komunës së Podujevës, përkitazi me ankesën, por nuk ka marrë përgjigje.

Nisur nga veprimet e ndërmarra nga IAP-ja në raport me Komunën e Podujevës dhe në drejtim të trajtimit të kërkesës së ankueses, Avokati i Popullit thekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, paragrafi 1, përcakton të drejtën për qasje në dokumente publike: "*Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.*" Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: "*Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me*

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e drejtuar nga ankuesi është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.” Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së: “Ky ligj garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuar, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik.”

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi nga Komuna e Podujevës i kërkesës së ankueses, përveçqë është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht bie në kundërshtim me parimin e administratës së hapur, i përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1: “Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.” Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq me vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit jua rikujton se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), sipas neni 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja në praktikën e saj vazhdimisht ka vlerësuar: “Liria e shprehjes përbën një nga themelet esenciale të një shoqërie demokratike, bazuar në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNj, dhe është e zbatueshme jo vetëm për “informacion” apo “ide” të cilat pranohen apo vlerësohen. [...] Jo vetëm që shtypi ka për detyrë të transmetojë informacione dhe ide të tilla, por publiku gjithashtu ka të drejtë t’i pranojë ato. Sikur të ishte ndryshe, shtypi nuk do të ishte në gjendje të luante rolin e tij jetësor të “mbikëqyrësit publik”.² Po ashtu, në rastin *Lingens v. Austria*, GjEDNj-ja ka theksuar: “[...] të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësisë, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Këto parime kanë një rëndësi të veçantë për sa i përket shtypit.” [...].³

Për më tepër, Gjykata Themelore në Prishtinë (GjThP), me Aktgjykimin A.nr.1335/12, i datës 26.5.2015, e kishte aprovuar kërkesëpadinë e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) në kontestin administrativ kundër Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me të cilin e kishte detyruar Zyrën e Kryeministrit, që t’ia lejonte qasjen BIRN-it në të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara.

Avokati i Popullit, në rastin në fjalë, konstaton se Komuna e Podujevës ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejinimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo që garantohet me instrumente ndërkombëtare dhe me akte vendore.

Obligimi ligjor për bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Podujevës, përveçse ka dështuar t’i përmbushë obligimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41) dhe nga LQDP-ja, përkitazi me qasjen në dokumentet publike, po ashtu ka dështuar t’i përmbushë obligimet që burojnë nga Kushtetuta (neni 132, paragrafi 3) si dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit (neni 25), në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent

² Case of Observer and Guardian V. The United Kingdom, (App. no. 13585/88, 26 November 1991, Paragraph 59 (a) (b)).

³ Case of Lingens V. Austria (App. no. 9815/82), 8 July 1986, paragraph 41.).

fillimin e procedurës administrative, duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyt në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe me fokus te qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe nga shoqëria civile.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i


REKOMANDON

Komunës së Podujevës

- *Ta trajtojë kërkesën e ankueses dhe t'i përgjigjet asaj, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi;*
- *T'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit